

**DEPARTEMENT
BILDUNG, KULTUR UND SPORT**

Vorsteher

Alex Hürzeler, Regierungsrat
Bachstrasse 15, 5001 Aarau
www.ag.ch/bks

Për
Prindërit e nxënësve të shkollës
Aargauer Volksschule

30 mars 2020

Informacion mbi mësimdhënien dhe kujdesin në distancë gjatë pandemisë të koronavirusit

Të nderuar prindër

Sipas vendimit të Këshillit Federativ të datës 13 Mars 2020 mbi zhvillimin e mësimin në klasa dhe sipas orëve të rregullta në të gjitha shkollat, është ndaluar mësimi që prej datës 16 Mars 2020. Vendimi është i vlefshëm deri në fund të pushimeve të pranverës më 19. Prill 2020. Në kantonin Argau u morën masat e menjëhershme që orët e rregullta të shkollës të pezullohen përkohësisht deri në festat e pranverës. Për më tepër, është caktuar një mundësi mbi kujdesin e fëmijëve për ata nxënës, kujdesi i të cilëve nuk është i garantuar në shtëpi sepse, për shembull prindërit duhet të punojnë ose kujdesi i fëmijëve duhet të transferohet në një grup risku.

Mendohet se situata aktuale e jashtëzakonshme mund të zgjasë më shumë dhe se këshilli federal mund të shtyjë vendimin mbi mbylljen e shkollave dhe pas pushimeve të pranverës. Për këtë arsye Departamenti i Edukimit, Kulturës dhe Sporteve (BKS) ka publikuar sot një udhëzim që përcakton mësimdhënien duke nisur nga data 20 prill 2020 në formën e "mësimdhënies në distancë". Shkollat kanë për detyrë të mbajnë mundësinë e kujdesit për fëmijët gjatë pandemisë së koronavirusit, përfshirë edhe gjatë pushimeve të pranverës.

Mësimi në distancë do të thotë që studentët do të mësojnë dhe do të punojnë nga shtëpia dhe se të gjitha njohuritë transferohen në distancë. Përgjegjsia mësimore mbetet ende përgjegjësi e shkollës. Prindërit, nga ana tjetër, janë përgjegjës për të planifikuar rutinën e përditshme me fëmijët e tyre dhe për t'u siguruar atyre vendin e punës më të përshtatshëm në shtëpi për mësimin e pavarur. Shkollat lokale zbatojnë mësimin në distancë sipas mundësive të kërkesave të shkollës dhe niveleve të shkollës nga njëra anë, si dhe kërkesave të nxënësve në shtëpi nga ana tjetër.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj. Duke vepruar kështu ju jepni kontributin tuaj të rëndësishëm në përballimin e situatës aktuale.

Përshëndetje të përzemërta



Alex Hürzeler, Këshilli qeverisës